



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS
Praktikum i Gjuhës B (2)

Ngarkesa në orë/kredite: 80 orë mësimore, 8 kredite; 80 seminare

Viti / Semestri : Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studentët do të zhvillojnë aftësi të avancuara në përdorimin e gjuhës greke, duke përvetësuar një fjalor më të pasur dhe njohuri më të thelluara mbi strukturat gramatikore dhe leksikore. Ata do të jenë të aftë të përdorin sinonime dhe antonime në mënyrë efektive, të kuptojnë dhe të interpretojnë si kuptimet literalë, ashtu edhe ato figurative të fjalëve, si dhe të shfrytëzojnë shumëkuptimësinë e tyre në kontekste të ndryshme komunikimi. Gjithashtu, studentët do të përmirësojnë aftësinë për të përshtatur stilin dhe nivelin e gjuhës në varësi të audiencës dhe situatës, duke përfshirë gjuhën formale dhe joformale. Në përfundim, studentët do të jenë në gjendje të zbatojnë rregullat e sintaksës dhe pikësimit me saktësi, duke prodhuar tekste të qarta dhe koherente.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojnë aftësinë për të përdorur sinonime dhe antonime në mënyrë të saktë, duke pasuruar fjalorin dhe përmirësuar shprehjen gjuhësore në kontekste të ndryshme.
2. Të kuptojnë dhe të dallojnë kuptimin literal dhe figurativ të fjalëve, si dhe të përdorin shumëkuptimësinë në mënyrë të përshtatshme për të komunikuar qartë dhe me precizion.
3. Të përshtatin stilin dhe nivelin e gjuhës sipas audiencës dhe situatës, duke përdorur struktura të ndryshme gjuhësore për të komunikuar në mënyrë formale dhe joformale.
4. Të përdorin saktësisht rregullat e sintaksës dhe pikësimit, duke krijuar tekste të strukturuar, të qarta dhe koherente, që respektojnë normat e gjuhës greke.

Rezultatet e pritshme:

1. Përdorin sinonime dhe antonime në mënyrë të saktë dhe efektive për të pasuruar shprehjen e tyre gjuhësore në greqisht.
2. Dallojnë dhe përdorin korrektësisht kuptimet literalë dhe figurativë të fjalëve, duke i përshtatur ato kontekstit dhe qëllimit të komunikimit.
3. Përshtatin stilin dhe tonin e gjuhës sipas audiencës dhe kontekstit, duke përdorur gjuhë formale dhe joformale me saktësi.
4. Aplikojnë rregullat e sintaksës dhe pikësimit për të shkruar tekste të strukturuar dhe të qarta, që respektojnë normat e gjuhës greke.